

RAPORT TEKNIK

PROJEKT ZBATIM: RIKUALIFIKIM I SHESHIT TË KRONIT TË BOGËS, MALËSI E
MADHE



Autorësia dhe kontributet:

Ky dokument u përgatit nga studio e projektimit TD architecture në bashkëpunim me stafin e Bashkisë Malësi e Madhe dhe falë kontributit financiar të Z.Cafo Boga dhe diasporës së Malësisë së Madhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Grupi i punës:

Taulant Dibra, Bledi Trashani, Iris Lohja, Festim Bregasi, Imeldi Sokoli, Roven Plaku, Frederik Shiroka, Elsid Sadiku, Përparim Bajraktari, Gerald Syka.

Bashkia Malësi e Madhe: Juljan Nokaj

Ark. Taulant Dibra	Ing. Frederik Shiroka
 Taulant Dibra	


Digitally signed by
Taulant Dibra
Date: 2020.10.06
10:38:23 +02'00'

PËRMBAJTJA

1.	Përshkrim i përgjithshëm.....	3
1.1	Aksesi dhe infrastruktura.....	3
1.2	Peizazhi.....	4
2.	Fshati Bogë.....	6
2.1	Zhvillimet historike.....	7
2.2	Tipologjia ndërtimore, teknikat dhe materialet e përdorura	7
3.	Situata aktuale e sheshit të Kronit të Bogës	12
3.1	Zona e ndërhyrjes.....	14
4.	Koncepti i projektit	15
5.	Prezantimi i projektit	17
5.1	Plani i përgjithshëm	17
5.2	Pamjet e projektit	17
6.	Ndërhyrjet pjesë e projektit.....	20
7.	Veprat e artit.....	35
8.	Shtresat rrugore.....	45

Në këtë Rajon kalojnë 3 akse rrugore të rëndësishme: Aksi rrugor Shkodër-Koplik-Razëm, Aksi Shkodër-Koplik-Vermosh dhe Aksi Shkodër-Koplik-Theth ku përgjatë këtij të fundit kalon edhe nëpër Luginën e Përroit të Thatë dhe në Fshatin Bogë. Distancat rrugore Shkodër-Bogë është 48 km dhe rreth 1 orë distancë kohore, ndërsa me Thethin kjo distancë shkon në 76 km dhe rreth 2 ore e 34 minuta distancë kohore. Në raport me pikat kufitare Fshati Bogë ka një distancë rreth 62 km dhe 1 orë e 20 minuta me pikën kufitare të Muriqanit si dhe 40 km dhe 50 minuta në raport me pikën kufitare të Hanit të Hotit. Duhet thënë se, në nivel lokal Fshati Bogë është mjaft mire i aksesuar, ndërsa në nivel rajonal ky akses është relativisht i dobët.

Harta 2. Harta e infrastrukturës ekzistuese



Burimi: PKST Alpe - Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit

1.2 Peizazhi

Alpet Shqiptare duke përfshirë dhe Fshatin Bogë përbëjnë një peizazh unikal në Shqipëri dhe rajon. Ato karakterizohen në tërësi nga peizazh me elementë të fortë e të dallueshëm që i japin kësaj hapësire një pamje piktoreske të shoqëruar me kontraste të forta.

Për efekt të karakterizimit më të plotë të peizazhit, peizazhi i zonës së Bogës bën pjesë në kategorinë kryesore të peizazhit malor, ku: Alpet paraqesin zonën më malore të vendit, dhe shtrihen në pjesën veriore të Shqipërisë. Përfaqësojnë krahinën fiziko-geografike më të lartë dhe më madhështore, kufijtë e tyre janë mjaft të qartë. Shtrihen në Veri të lumit Drin në Perëndim të rrjedhjes së poshtme

të lumit Valbonë (degë e Drinit). Dallohen për shumëllojshmërinë e peizazheve fiziko-gjeografike. Kanë pozitë gjeografike tepër të izoluar, sepse rrugët që i lidhin me rajonet e tjera të vendit dhe trevat shqiptare jashtë kufirit, janë të pakta dhe në gjendje të jo të mirë.

Njëherazi dallohen për grumbullin malor më të fuqishëm, më të lartë, më të ashpër dhe më të copëtuar të vendit. Lartësia mesatare e tyre mbi nivelin e detit arrin në 1500 m. Këtu ndodhen dhe shumica e majave të Shqipërisë me lartësi mbi 2000m, majën më të lartë e Alpeve, Jezerca (2694m), e dyta pas majës së Korabit (2751m). Morfologjia karakterizohet nga shpate të thepisura, me lugina të thella akullnajore, me gryka të ngushta me pragje të shumta, në të cilat ka liqene, pyje dhe kullota të pasura, që paraqesin bukuri të rralla natyrore jo vetëm në Shqipëri, por dhe për Ballkanin.

Figura 1. Fotografi nga Fshati i Bogës



Burimi i fotografisë: TD architecture Studio

2. Fshati Bogë

Boga ndodhet në pjesën e sipërme të Përroit të Thatë rreth 48 km në veri të qytetit të Shkodrës dhe 37 km larg qytetit të Koplikut.

Lugina e Bogës, që për nga origjina është akullnajore, ka formën e një rrethi ku malet që e rrethojnë formojnë kolona me lartësi mbi 2000m. Nga malet që e rrethojnë, kur shkon për në Bogë, nga e djathta shtrihet maja e Rabës (2222m), vazhdon më tej me malin e Çardakut (2250m) dhe me majën e Shtegut (2083m) ku lidhet me malin e Radohinës dhe me malin e Arapit që e ndajnë nga lugina e Thethit, ndërsa në krahun e majtë, shtrihen Mali i Pultinzes, më pas mali i Dragomirit, mali i Bridashës (2187m) e pastaj maja e Vuklin ku lidhet me Radohinën.

Fshati i Bogës njihet për biodiversitetin e lartë. Përgjatë luginës së Bogës takohen disa kate bimore si shkurret ku mbizotëruese është lajthia dhe dëllinja. Kati tjetër është ai drunjëve të lartë ku mbizotërues është ahu dhe kullota alpine.

Në këtë zonë po ashtu mund të gjejmë bimë endemike të rralla si: Eulfenja e Baldacit, që gjenden në shteg të dhenve, në qafë Shtogu si dhe Crekus i Dalmacisë që gjendet në Bjeshkët e Namuna, Radohinë etj. Ndërsa, fauna përfaqësohet nga 25 lloje gjitarësh, të tilla si: dhia e egër, macja e egër, vjedulla e zardafit dhe mbi 40 lloje shpendësh ku nga këto janë të rralla: gjeli i egër, shgiponja e malit dhe pula e pyllit.

Figura 2. Fotografi nga Fshati i Bogës




Burimi i fotografisë: TD architecture Studio

2.1 Zhvillimet historike

Trojet e Bogës janë karakteristike edhe e dëshmime arkeologjike të vendbanimeve të hershme ku kanë jetuar banorët e parë ilirë të shek. II-III siç janë; Shpella e Puçit, Shpellën e Cilikokajve, Shpella e Madhe e cila është shpella më e rëndësishme në Bogë dhe formën e një salloni të madh. Është një vendbanim parahistorik me vlera historike.

Boga është emër mali, bajraku apo fshati, me një histori qindra apo mijëra vjeçare. Në trojet e Bogës janë gjetur dëshmi arkeologjike të vendbanimeve të hershme Ilire, (të kohës romake fundi i shekullit II, shekulli III mbas lindjes së Krishtit). Kjo histori përveç dokumenteve të shkruara nga studiues të ndryshëm, ka ardhur deri në ditët tona edhe nëpërmjet gojëdhënave të trashëguara nga banorët autokton të Bogës. Boga si vendbanim njihet të paktën që në shekullin e XV. Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, fq.128 (përpiluar nga pushtuesi Otoman për qëllime taksash) e regjistron Bogën si fshat me dy shtëpi, dhe të përfshirë në Nahijen (Komunën) e Pipërve. Ndërsa një burim tjetër tregon se Boga kishte tetë shtëpi dhe të gjitha ishin të besimit Kristian. Në organizimin e Bajraqeve (fundi i shekullit XVII), Boga shkruhet se është një ndër katër Bajraqet e Kelmendit. Sipas gojëdhënave Boga ishte emri i djalit të dytë të Klementit (të parit të Kelmendit). Nga djali i dytë rrjedh fisi i vogël i Bogës, që bën pjesë në Fisën e Kelmendasve, dhe është vendosur ndërmjet maleve të Shkrelit, Kastratit, Shalës dhe Kelmendit.

Harta 2. Fshati Bogë në vitin 1960 (hartë topografike 1:150000)



Burimi: ASIG Gjeoportali

2.2 Tipologjia ndërtimore, teknikat dhe materialet e përdorura

Arkitektura tradicionale ka një vlerë të veçantë turistike. Ajo tregon ndërtimin individual, i cili është autentik, origjinal dhe i rrallë. Banesat tradicionale, objektet e shërbimeve publike dhe ato të kultit janë shumë të rëndësishme në turizmin e zonave rurale malore në Alpet Shqiptare.

Zona e Shqipërisë së veriut dallohet për një arkitekturë me identitet të theksuar, shkak për formimin e së cilës kanë qenë kushtet historike, natyrore, topografike apo ekonomike. Banesat karakterizohen nga kompozime të thjeshta vëllimore, hapësira me funksione të ndara nga njëra – tjetra, sipërfaqe të plota, me hapësira ndriçimi të vogla e të pakta, dhe nga përdorimi tepër i kursyer i elementeve dekorative. Të vetmet elemente që bien në sy në pamjen e jashtme janë dyert, herë të punuara me mbulesa në formë harku me gurë të latuar. Vëllimi i mbyllur dhe ndërtimi me gurë i japin banesës karakter mbrojtës.

Figura 3. Fotografi e Kishës së Bogës (Vitët 1940-1950)



Figura 4. Fotografi nga Fshati i Bogës (Vitët 1920 -1930)



Burimi: Muzeu Kombetar i Fotografisë “Marubi”

Materialet e përdorura, janë;

Guri, si materiali kryesor i ndërtimit në krahinat malore duke shërbyer për muret mbajtëse të godinave të kultit dhe ndërtesave të banimit.

Druri, material gjithashtu shumë i përdorur, gjendej gjerësisht në zonat malore dhe shërbente zakonisht për dysheme dhe çati.

Figura 5. Banesë – Fshati Bogë



Burimi i fotografisë: TD architecture Studio

Muret - teknika më e përhapur e muraturës ka qënë me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Në disa raste është përdorur teknika me mur të thatë, pa llaç, e përdorur kryesisht në banesat e thjeshta dhe në ndërtimet e përkohshme si kasolle, stane, etj. Kujdes të veçantë i kushtohet qosheve të ndërtesës, të cilat janë ndërtuar me gur të latuar. Mbushja e muraturës bëhet me gurë të papërpunuar, gjë që krijon një sipërfaqe të ashpër, ndonëse fugaturat mbushen mire me llaç gëlqereje. Elemente guri të latuar shihen në mbulesat në formë harku të dritareve dhe të portave.

Çatia – element karakteristik i banesave në zonën malore. Format më tipike janë me dy kullime uji, me pjerrësi në faqet gjatësore ndërsa dy faqet e ngushta ngrihen deri sipër për të mbyllur hapësirën e çatisë. Këto forma janë të përshtatshme për vëllimet e thjeshta prizmatike të banesave. Teknika e ndërtimit të tyre është e thjeshtë dhe nuk kërkon shumë lëndë drusore. Trarët mbështeten në muret gjatësore dhe kapen me njëri tjetrin në kulm ose mbështeten në kulmar. Mbulesa kryesisht bëhet me dërrase. Në fillim të shekullit XX u futën në përdorim “çatitë alpine” të cilat kanë pjerrësi shumë të madhe dhe mbulohen me furde dërrase. Kjo bën që dëborat të rrëshqasë duke mos ngarkuar konstruksionin e çatisë dhe njëkohësisht hapësira nën çati është e shfrytëzueshme, në disa raste si depo ose si dhoma të vogla fjetjeje.

Figura 6.



DREDITARE



PORTE ME HARK




DERE DRURI




Burimi i fotografisë: TD architecture Studio


Figura 7.



MBULESE ME DRU PISHE



TIPOLOGJI MURATURE



DRITARE




Burimi i fotografisë: TD architecture Studio

3. Situata aktuale e sheshit të Kronit të Bogës

Sheshi i Kronit të Bogës aktualisht paraqitet në një situata jo mjaft të pëlqyeshme. Objektet, kryesisht të ndërtuara pas viteve 90, na ofrojnë një siluetë aspak të këndshme.

Harta 3. Gjendje ekzistuese e sheshit të Kronit të Bogës dhe zonave përreth



Burimi: TD architecture Studio

Figura 8. Fotografi, Sheshi i Kronit (Situata Aktuale)



Figura 9. Fotografi, Sheshi i Kronit (Situata Aktuale)



Burimi: TD architecture Studio

3.1 Zona e ndërhyrjes

Zona e ndërhyrjes, pra zona e projektuar shtrihet në një sipërfaqe të përafërt prej 5000m², dhe përfshin; rikualifikimin e sheshit me një sipërfaqe rreth 1450m² dhe ndërhyrje në nëntë objekte ekzistuese.

Harta 4. Horografi



Harta 5. Objektet në të cilat do ndërhyhet



4. Koncepti i projektit


Bazuar në dokumentet e planifikimit të hartuara dhe në fuqi si, Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK), Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit (PKST Alpe) dhe Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV), kemi konceptuar projektin e Sheshit të Kronit të Bogës, bazuar në tre akse kryesore: Rekreacion, Kulturë dhe Turizëm.

Rekreacioni, një ndër objektivat kryesor të këtij projekti, me anë të së cilit synojmë të hapim sheshin e Kronit të Bogës, ta bëjmë atë sa më atraktiv për turistët duke organizuar aktivitete të shumta rekreative. Burimi i ujit te pijshëm, zonat për tu çlodhur, infopoint-i, aktivitetet komerciale si, baret dhe restorantet e rinovuara në arkitekturën tradicionale, do e bëjnë sheshin e Kronit, një qendër të rëndësishme për Fshatin Bogë dhe gjithë Njësinë Administrative Shkrel.

Kultura, është objektivi kryesor i cili duhet zhvilluar rreth sheshit respektiv. Aktivitetet kulturore së bashku me ato rekreacionale dhe turistike, kanë një potencial të madh për të tërhequr turistët, si ato vendas dhe ato të huaj. Fushat kryesore kulturore dhe ato të traditës që mund të eksplorojmë dhe të evidentojmë në sheshin e projektuar, janë: Kroni i Bogës dhe legjenda e tij, galeritë nëntokësore të Kronit dhe projekti i tyre i cili daton në vitin 1938, arti dhe artizanati autokton, arkitektura tradicionale, kulinari, flora dhe fauna, etj.

Promovimi i vlerave kulturore jo vetëm që, ndihmon popullsinë vendase dhe gjeneratat e ardhshme të vlerësojnë më shumë rrënjët e tyre kulturore dhe mjedisin/klimën e mrekullueshme të Bogës, por ndihmon dhe në aktivizimin e industrisë kulturore dhe turistike, duke promovuar kështu dhe ekonomine lokale.

Promovimi i Turizmit është objektivi i tretë i projektit, i lidhur ngushtë me aktivitetet rekreacionale dhe ato kulturore. Sheshi, tashmë i hapur dhe i ri konceptuar, legjenda e Kronit, arkitektura tradicionale e evidentuar në objektet rreth sheshit, infopoint-i por dhe një menaxhim i mirë nga strukturat lokale i sheshit në fjalë, do promovoj mjaft mirë ofertën turistike lokale, Fshatin Bogë me gjithë ambientin e saj te jashtëzakonshëm natyror.



Me anë të këtij projekti japim kontributin tonë duke punuar bazuar në rekomandimet e evidentuara në Dokumentet e Planifikimit në fuqi (PPK, PKST Alpe, PPV), respektivisht;

- Krijimi i qendrës së fshatit;
- Rikualifikim i qendrës rurale Bogë;
- Krijim sheshesh dhe lulishtesh në vendbanime;
- Evidentimi i godinës tipike karakteristike të fshatit;
- Ruajta dhe promovimi i objekteve me arkitekturë tradicionale, evidentim dhe katalogim;
- Nxitja e transformimit të godinave me arkitekturë tradicionale në struktura të hapura për publikun;
- Krijimi i strukturave informuese turistike për promovim dhe marketim në përputhje me karakteristikat e lokaliteteve dhe të zonave turistike natyrore;
- Dizajnimi i strukturave të qendrave informuese turistike me elementë arkitektonikë që identifikojnë unitetin e zonës së alpeve;
- Sigurimi i ambienteve për aktivitete kulturore, muze, biblioteka, librari, pika suveniresh, tregtim produktesh lokale, etj.;
- Mbjellje pemësh në zonat me erozion;
- Pajisja e lokalitetit me infrastrukturën e parkimit publik.

5. Prezantimi i projektit

5.1 Plani i përgjithshëm

Harta 6. Plani i Përgjithshëm



I gjithë koncepti i projekti të ri bazohet në tre kapituj kryesorë;

- Ri konceptim i sheshit të Kronit të Bogës, në një logjikë moderne por bazuar në materialet/elementet tradicionale ndërtimore.
- Ri konceptim i projektit Italian të Kronit dhe Ujësjellësit (viti 1938), në të njëjtën logjikë por tani me një trajtim/ me një koncept të ri dhe bashkëkohor.
- Unifikimi i zonës përreth sheshit, sërish bazuar dhe duke përdorur materialet ndërtimore autoktone.

Në projektin e ujësjellësit projektuar nga inxhinierët italian në vitin 1938, hasim "Kronin" në një strukturë një planëshe dhe hasim "Lugun", aty ku lanin rrobat gratë e fshatit dhe pinte ujë bagëtia. Në projektin e ri, gjejmë sërish të njëjtën logjikë "Kroni - Lugu" por në një atmosferë tjetër, në një koncept sa modern për nga forma, aq dhe tradicional për nga materiali.

5.2 Pamje projekti

Sheshi i Kronit të Bogës do të bëhet një pikë reference e rëndësishme për Fshatin e Bogës dhe gjithë Njësinë Administrative Shkrel, kjo dhe për shkak të vendndodhjes së saj strategjike. Ajo do të jetë hapësira e lirë për këmbësorë që do të funksionojë si një pikë takimi dhe zonë argetuese. Sheshi i Kronit të Bogës është konceptuar si një pikë aktive takimi që nxit ndërveprimin e qytetarëve, si një zonë në zhvillim e cila mund të përdoret çdo ditë si një vend grumbullimi.

Një auditor i vogël në natyrë mund të integrohet në dizajnin e peizazhit që do të përdoret si një zonë pushimi për vendasit dhe turistët, në raste të veçanta, si një zonë për ngjarje publike si koncerte dhe festa por dhe aktivitete tregtare.

Pamje Projekti



Pamje Projekti



Pamje Projekti



Pamje Projekti




6. Ndërhyrjet pjesë e projektit

Pjesë e projektit të ri, ndërhyrjet në këtë shesh konsistojnë, në;

- Punime në infrastrukturën nëntokësore; KUB, Ujësjellës dhe punime elektrike.

Projekt KUB



Projekt Elektrik



- Rikonceptim i sheshit në fjalë, nga ku, gjejmë rreth 900m² shtrim në pllaka guri, 115 m² rrugë dekorative, 145m² të shtruara në asfal për parkim (vend parkimi për 10 makina),

Pamje Projekti



Tipologjitë e shtrimit (pllaka guri, gurë dekorativ, asfalt)

D1. Prerje në shesh

Strim pllake guri, ngjyra sipas planit 6cm
Shtrese llaçi 4 cm
Shtrese betoni i perforcuar C 20/25
15 cm zgare hekuri Ø8 20x20 cm
Shtrese çakelli 15 cm
Toke natyrale

D2. Prerje në rrugë buto betoni

Shtrese buto betoni C 12/15 me gur te punuar 15 cm
Shtrese betoni i perforcuar C 20/25
15 cm zgare hekuri Ø10 20x20 cm
Shtrese çakelli 15 cm
Toke natyrale

D3. Prerje në parking

Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri
Shtrese binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri
Shtrese stabilizant 10 cm
Shtrese çakelli 15 cm
Toke natyrale/Mbushje

- Rimodelim dhe përmirësim funksional i Kronit të Bogës. Zëvendësim i strukturës së vjetër të Kronit, me një strukturë të re, pjesë e kompozimit të gjithë sheshit të projektuar. Siç u shprehëm dhe më lart, kompozimi i projektit të ri bazohet në skemën e projektit të vitit 1938 projektuar nga inxhinierë italian, pra një kompozim i cili përfshin Kronin dhe Lugun. Në rastin e projektit të ri, Lugun e gjejmë në formën e një “Ujëmbledhësi” të pozicionuar pothuajse në qendër të sheshit të projektuar, i cili së bashku me kronin përfaqësojnë elementin më të rëndësishëm kompozicional të projektit.

Përveç punimeve në aspektin vizual dhe struktural të Kronit dhe Ujëmbledhësit, në projekt përfshihen dhe punime përmirësimi të anës funksionale të tij. Si rrjedhojë lidhja e tubacionit të ri të ujësjellësit me tubacionin e vjetër do të bëhet në dalje të rezervuarit, me anë të një rakorderie përshtatëse. Kjo linjë do të jetë material PE me diametër nominal 63mm, dhe, do bashkohet në një pusetë komandimi, të re, të pozicionuar mbrapa kronit. Nga kjo pusetë komandimi do furnizohet kroni si dhe ujëmbledhësi në qendër të sheshit të projektuar. Secila dalje do komandohet me anë të saraçineskave të komandimit.


Pamje Projekti



Pamje Projekti



Projekt Ujesjellës – Kroni Bogës



Struktura e Kronit. Në projektin e ri struktura e Kronit, një strukturë e shkëputur nga një shkëmb i zonës, ndahet në një mënyrë të çrregullt, dhe nëpërmjet kësaj të ndare, kur ngrihemi nga pirja e ujit të Kronit, mund të shikojmë "Shpellën e Madhe", e cila po ashtu personifikon në një farë mënyre dhe fillimin e historisë së Kronit të Bogës. (bazuar në legjendë).

Si më lart, kjo strukturë do jetë e punuar në blloqe guri (e preferuar, blloqe guri të zonës) të pozicionuara me kujdes (si në projekt), dhe mbi të skulptori do bëjë implementim basorelievin.


(në zonën e përcaktuar në projekt)

Basorelievi do realizohet me mjete bashkëkohore (fleksibel, dhe freza profesionale, që sigurojnë realizimin sa më artistik dhe mjeshtëror të objektit) dhe do ketë gjithashtu ndërhyrje me vegla tradicionale (dalte, çekiç, lima dore) pa prishur aspak strukturën dhe uniformitetin e përgjithshëm të blloqeve të gurit. Kjo gjë do arrihet, nëpërmjet kontrollimit të thellësisë në të cilën do ndërhyhet, dhe mjeshtërisë së lartë artistiko-artizanale, nga artisti që do kryejë këtë punim.


Gjithashtu, punimi i basorelievit do kryhet me mjaft kujdes, për të mos dëmtuar strukturën e brendshme të blloqeve të gurit.

Një kujdes i veçantë duhet të tregohet dhe në punimet hidraulike, të cilat në bashkëpunim me skulptorin duhet të garantojnë mirë funksionimin e strukturës së re.

Projekt – Kroni Bogës




Pamje projekti dhe Basoreliev




- Elemente ndërtimore autoktone (dritare, derë)





Ndërkohë, projekti i rikualifikimit të fasadave përfshin, prishjen e një objekti një katësh me sipërfaqe të përafërt prej 23m², i cili gjendet në qendër të sheshit respektiv, sikurse një ndërhyrje pjesore në godinën ngjitur, respektivisht, në objekti 3. Pjesa tjetër e fasadave të objekteve në zonën në fjalë (6 objekte), rikualifikohen.

Plani i prishjeve



- Mbi 200 m² gjelbërim, disa pemë dekorative dhe shkurre autoktone të mbjella (bimësi endemike, bimësi e mesme dhe bimësi e lartë).

SKEDAT E PEMEVE TE PERDORURA BIMËSI ENDEMIKE (Shkurret)		
EMRI	FOTO	PËRSHKRIMI
YLLI ALPIN <i>Aster alpinus</i>		Ylli Alpin (<i>Aster alpinus</i>) Është bime endemike që rritet në Alpe, arrijn lartësinë deri në 30-50 cm.
KËRLEKA <i>Pinus mugo</i>		Kërleka (<i>Pinus mugo</i>) Futet tek llojet e pishës, ka trung pothuajse të drejtë me kurorë në formë piramide dhe gjethe në formë halash.
BUSHI <i>Buxus sempervirens</i>		Bushi (<i>Buxus sempervirens</i>) Është një nga 70 llojet e ndryshme të Buxus. Qendron gjithnjë e gjelbërt dhe mund të krasitet në formë të ndryshme.

SKEDAT E PEMEVE TE PERDORURA BIMËSI E MESME		
EMRI	FOTO	PËRSHKRIMI
LAJTHIA <i>Corylus avellana L.</i>		LAJTHIA (<i>Corylus avellana L.</i>) Bën pjesë në familjen Corylaceae. Arrin lartësi mesatare 3-8 m. Rritet veçmas ose e përzierë me shkurre si shkoza, mëlleza, thana etj. Bima parapëlqen shpatet e drejtura nga veriu ose verilindja që nuk rrihen nga dielli
FISHAKUQI <i>Eonumus europaeus</i>		FISHAKUQI (<i>Eonumus europaeus</i>) Rritet në 3-6 m lartësi me një trung deri në 20cm diametër. Gjethet janë të dhëmbëzuar dhe të imët. Ngjyra e kurorës të pemës varion në ngjyrë purpurt-vjollcë.

SKEDAT E PEMEVE TE PERDORURA BIMËSI E LARTË		
EMRI	FOTO	PËRSHKRIMI
AHU <i>lat. Fagus</i>		AHU (<i>Fagus</i>) është një pemë gjetherënëse që bën pjesë në familjen Fagaceae. Është pemë e madhe që mund të kalojë 35 metra lartësi dhe 1.5 metra diametër të trungut.
HITHESI <i>Ulmus glaber</i>		HITHESI (<i>Ulmus Glaber</i>) Rritet ne zonat me lartësi deri 1500m. Perdoret në parqet urbane dhe përgjatë rrugëve, Druri nuk është i ndonjë cilësie të mirë, por përdoret nga industria e prodhimit te mobiljeve.
VADHJA <i>Sorbus domestica</i>		VADHJA (<i>Sorbus domestica</i>) Pemë që rritet në lartësi 15-20 m e gjatë, Trungu arrin diametër deri ne 1m, Ngjyra e gjetheve ndryshon gjate ndryshimit te stineve ato marrin ngjyre të verdhë-jeshile ne vjeshte-dimer dhe të purpurt-vjollcë gjate pranveres.
FRASHËRI E BARDHE <i>Fraxinus ornus</i>		FRASHËRI I BARDHE (<i>Fraxinus Ornus</i>) Dallohet lehtësisht nga lëvorja karakteristike me ngjyrë gri të çelët, por edhe degët me nga tetë gjethe të mëdha në formën e heshtës. Është një pemë shumë popullore qe perdoret dhe në mjekësinë popullore per vetitë kuruese qe ka.

- Mobilim urban dhe sinjalistika rrugore


Përsa i përket mobilimit urban, duke u gjendur në një kontekst të tillë dhe mjaftë të veçantë, sërish kemi përdorur materiale lokale, modele të tilla, ngjyra sa më neutrale dhe shkëputur nga konteksti, në mënyrë që të jemi sa më delikat në ndërhyrjet tona.

Mobilimi urban është një fushë e projektimit që mundëson pajisjen e hapësirave publike urbane me objekte fikse apo të lëvizshme, funksionale dhe ndikon në përmirësimin e imazhit të vendit. Një projektim i mirë, duhet të jetë i aftë të përcaktojë të gjithë elementët që karakterizojnë format, materialin, ngjyrën, hapësirën si dhe mënyrën e përdorimit të saj nga njerëzit.


Elementet kompozues të arredimit të hapësirave publike mund të ndahen në dy kategori;

- Elemente e komunikimit,
- Elementet e mobilimit urban


Mobilim Urban; Gardh, Porte dhe reklama paralele



Mobilim Urban; Kosh mbeturinash dhe sinjalistika rrugore vertikale



Mobilim Urban; Tabela informuese vertikale



- Ndriçimi, në sheshin e projektuar, një element mjaft i rëndësishëm i projektit në tërësi, është një kompozim i katër tipologji ndriçuesish, respektivisht;
- Ndriçues Sheshi Shtyllor 425cm - janë ndriçues vertikal me shtyllë Ø20cm, 3m të larta dhe me një ndriçues tubolar Ø20cm, 1.25m i lartë, me 2 llamba fluoreshente 54W të instaluar brenda ndriçuesit. Përzgjedhja e këtij ndriçuesi u realizua duke marrë parasysh lartësinë e ulët që kërkohej për shtyllën e ndriçimit, dhe si pasojë e lartësisë së shtyllave, modeli i ndriçuesit u përzgjodh me ndriçim indirekt.
- Ndriçues mural i inkasuar - janë ndriçues mural të instaluar brenda muri, ku vetëm 1.8cm është në dukje, mbi faqen e murit. Janë ndriçues me një madhësi të vogël, por me një dritë të mjaftueshme për ambientin dhe me kënd të gjerë për përhapje më të mirë të dritës.
- Ndriçues sheshi i ulët H = 110cm - janë ndriçues vertikal me shtyllë Ø20cm, 1m të lartë, me ndriçues LED të inkorporuar. Të përshtatshëm për kalime të ngushta dhe për ambiente të vogla, pasi edhe lartësia e ulët realizon hapje të vogël të ndriçimit.
- Ndriçues spot gjuajtës i inkasuar – janë ndriçues të vegjël të cilët nuk kanë hapje të madhe, dhe vendosen në figura arkitektonike. Kanë një rezistence të madhe ndaj goditjes dhe një rezistence statike shumë të madhe me mbi 2 ton. Instalohen nën sipërfaqe dhe kanë një ekspozim minimal.


SASIA E NDRICIMIT, Klasifikimi i sheshit është bërë bazuar në normat e CEN/TR 13201-1: 2004 (E) të përgatitura nga CEN/TC 169 dhe aprovuar nga CEN ne 25 Gusht 2003. Sheshi përfshin vetëm këmbësorë dhe janë të përjashtuar mjete të motorizuara, mjete të lehta të pa motorizuara. Sipas këtyre të dhënave, sheshi do të ketë klasifikimin E1. Duke marrë në përlllogaritje faktorë të tjerë të nën klasifikimit si: koeficienti i riskut për krimin, koeficienti për njohjen e fytyrës dhe koeficientin e trafikut të këmbësorëve do te kemi nën klasifikimin S1. Sipas klasifikimit S1 duhet të respektohen parametrat e mëposhtëm:

- Niveli mesatar i ndriçimit: 10 - 15 lx
- Niveli minimal i ndriçimit: 2 lx
- Niveli minimal vertikal i ndriçimit: 3 lx

Bazuar ne projekt, të dhënat paraprake të tij dhe parametrat e ndriçesit, rezultatet janë si më poshtë:

- Niveli mesatar i ndriçimit: 13.18 lx
- Niveli minimal i ndriçimit: 8.72 lx
- Niveli minimal vertikal i ndriçimit: 8.81 lx

NDRICUESI SHESHI H 425CM




NDRICUESI SHESHI I ULET H 110CM



REFERENCE - NDRICUES SHESHI



NDRICUES MURAL I INKASUAR



Pershkrimi:
Ndricues mural i inkasuar me hapje te gjere te drites, i pershtatshem per shetitore

- Materiali i ndricuesit: alumin
- Ngjyra e ndricuesit: gri (Akzo Nobel 900)
- Materiali i xhamit: qelq i temperuar 8mm
- Dimensionet e ndricuesit: 23 x 10 x 9 cm
- Lampa: LED 11.3W
- Ngjyra e drites: 4200K
- Sasia e ndricimit: 436 lm
- Masa e ndricuesit: 1.05Kg
- Indeksi CRI: 70

NDRICUES SPOT GJUAJTËS I INKASUAR



Pershkrimi:
Ndricues spot i rumbullaket, i pershtatshem per ndricimin e dekoreve arkitektonike.

- Materiali i ndricuesit: alumin
- Materiali i kapakut: ocelik 3mm
- Ngjyra e ndricuesit: metalike inox
- Materiali i xhamit: qelq i temperuar 12mm
- Kutia e montimit: polipropilen
- Shkalla e mbrojtjes: IP67
- Lartesia totale: 17.5cm
- Diametri i dukshem: 11.3cm
- Lampa: LED 2.5W
- Ngjyra e drites: 4000K
- Sasia e ndricimit: 92 lm
- Kendi i hapjes se drites: 24°
- Masa e ndricuesit: 1.74Kg
- Indeksi CRI: 80

REFERENCE PAMJE NDRICUESI



LIDHJA ELEKTRIKE, Parametrat referues të parashikuara nga normat UNI 10439 janë përcaktime të vlefshme për të gjitha vendet e Europës. Ky projekt është përgatitur duke zbatuar normat CE, e veçanërisht ato CEI që janë standardizuar me ato të Komunitetit European. Gjithashtu materialet që do të zgjidhen për të zbatuar këtë projekt janë specifikuar si prodhime të standardizuara me kualitete IMQ. Sistemi i ndriçimit do të ushqehet me energji elektrike me tension të ulët TU 380V, nga kabina në administrim të OSHEE sh.a.

Kabllo të shpërndarjes në këtë sistem do të zgjidhen sipas normave CEI 20-13 dhe CEI 20-22 të tipit FG70R 0.6/1KV ose përcjellësi N07V-K 450/750V. Materiali izolues i kabllove dhe përcjellësve (tela) duhet të jenë rezistent ndaj zjarrit dhe nuk duhet të prodhojnë gaze helmuese gjatë djegies. Kodifikimi sipas ngjyrave do të jetë, për fazet: kaf, zi dhe gri, për nulin (neutrin): blu, dhe për përcjellësin e tokëzimit do të jetë verdhë-jeshil. Mbrojtja nga kontaktet direkt është parashikuar të bëhet në dy mënyra:

- Tokëzim i çdo komponenti metalik.
- Përdorimi i linjave me dy shtresa izolimi.


Për të realizuar pikën e parë duhet që të gjitha masat metalike të pajisjeve të lidhen me tokën me një përcjellës bakri të veçantë që bën lidhjen e çdo komponenti metalik me elektrodën individuale të tokëzimit, siç është prezantuar dhe në projekt. Për sa i përket pikës së dytë duhet që, futja e kabllove në ndriçues të bëhet me tub plastik me mbrojtës me dy shtresa, morseteria e ndriçuesit të jetë me klasë izolimi II, dhe linjat duhen të jenë kablllo me minimum dy shtresa izolimi.

- Ndërhyrjet në galerinë nëntokësore, siç është prezantuar dhe më parë (dhe në fazën e analizës së situatës aktuale) struktura e furnizimit me ujë të Kronit të Bogës është projektuar diku nga viti 1938 nga inxhinierë italian, dhe ndërtuar pak a shumë në këtë periudhë.


Kjo strukturë e projektuar dhe ndërtuar me shumë mjeshtri e cila funksionon me rënie të lirë të ujit, është e kompozuar me dy galeri nëntokësore të cilat mbledhin ujin e pijshëm në një “pusetë ujëmbledhëse”. Nga kjo pusetë uji i pijshëm po në rënie të lirë, shkon drejt kronit.

Tepricat e ujit mbledhen në një rezervuar nëntokësor me një vëllim goxha të madh. Nga ky rezervuar furnizohej lugu në të cilin pinin ujë bagëtitë dhe përdorej për larjen e rrobave, nga gratë e fshatit.

Skemë funksionale – Projekt 1938




Projekt Galeria Nëntokësore – Projekt 1938




Burimi: Arkiva e Ndërtimit

Projekt "Cezme" – Projekt 1938



Projekt "Lugu" – Projekt 1938



Burimi: Arkiva e Ndërtimit

Galeria nëntokësore, aktualisht paraqitet në gjendje të mirë, po ashtu dhe puseta ujëmbledhëse. Galeria në përgjithësi ka nevojë për pastrim të inerteve të tepërta apo dhe atyre të rëna nga struktura ekzistuese, nga efekti kohe. Fugat e mureve prej guri kanë nevojë për një pastrim dhe rehabilitim të lehtë, si në kafazin e shkallës që të zbret për në galerinë nëntokësore, ashtu dhe në muraturën ekzistuese të galerisë.

Është ristrukturuar porta hyrëse për në galerinë nëntokësore, e cila tashmë ka një mbulesë prej xhami (të temperuar) për të lejuar shikueshmërinë në interiorin e saj. Zëvendësohen shkallët ekzistuese të cilat janë të dëmtuara, dhe gjithashtu galeria pajiset me sistem të thjeshtë ndriçimi.

Në sheshin e krijuar pranë portës hyrëse për në galerinë nëntokësore, propozohet vendosja e një table informuese e cila do jap informacionin e nevojshëm për galerinë nëntokësore, ujin e pastër dhe të shëndetshëm të Kronit të Bogës dhe projektit të parë të Kronit, të ndërtuar (Viti 1938).

7. Veprat e Artit

- Qëllimi i raportit

Ky raport prezanton në mënyrë të përmblendhur rrugën që është ndjekur për projektimin e mureve mbajtës dhe pritës në kuadër të projektit të projektit “Rikualifikim i sheshit të kronit të bogës”, Bashkia Malësi e Madhe. Në raport jepen të dhëna që janë marrë në konsideratë gjatë projektimit të mureve mbajtës dhe pritës betonarme.

Më poshtë janë paraqitur tipet e mureve betonarme që janë përdorur:




Figura 1. Mure betonarme, Hmes=0.75 m




Figura 2. Mure betonarme, Hmes=2.5 m




Figura 3. Mure betonarme, Hmes=3.4 m




Figura 4. Mure betonarme, Hmes=0.75 m




Figura 5. Mure betonarme, Hmes=1.2 m




Figura 6. Mure betonarme, Hmes=2.7 m




Figura 7. Mure betonarme, Hmes= 3.65 m




Figura 8. Mure betonarme, Hmes= 2.40 m

Këto mure janë llogaritur dhe dimensionuar sipas kriterëve të projektimit europianë. Muri është kontrolluar sipas të gjitha kriterëve që paraqiten në normat europiane duke përfshirë kontrollin në rrëshqitje, në përmbysje, llogaritja e planit më të keq të rrëshqitjes. Më poshtë do të japim raportin teknik të llogaritjes së një tipi të një muri pritës që është përdorur në këto segmente.

- Kriteret dhe Normat e projektimit

Për të llogaritur muret mbajtës dhe pritës janë shfrytëzuar normat e mëposhtme:

- Kushtet Teknike të Projektimit Shqiptare (KTP-78);
- Kushtet Teknike të Projektimit Evropian (Eurocode);
 - o *Eurocode 0 (EN 1990) – Bazat e projektimit strukturor;*
 - o *Eurocode 1 (EN 1991) – Veprime mbi strukturat;*
 - o *Eurocode 2 (EN 1992) – Projektimi i strukturave prej betoni;*
 - o *Eurocode 7 (EN 1997) – Projektimi gjeoteknike;*
 - o *Eurocode 8 (EN 1998) – Projektimi i strukturave rezistence ndaj tërmeti;*

- Njësitë

Sistemi i njësive që do të përdoret në llogaritjet dhe projektimin e strukturës është sistemi S.I.

Më poshtë janë dhënë njësiet që do të përdoren:

- | | |
|---------------------------------|--|
| - Forcat dhe Ngarkesat | kN, kN/m, kN/m ² ; |
| - Densiteti dhe masa | kg/m ³ , t/m ³ kg, t; |
| - Pesha njësi (Pesha specifike) | kN/m ³ ; |
| - Sforcimet dhe forcat | N/mm ² (MN/m ² or MPa), kN/m ² (kPa); |
| - Momentet | kNm; |
| - Nxitimi i truallit | m/s ² , g (= 9,81 m/s ²); |

- Kërkesat e durueshmërisë

Një strukturë e qëndrueshme duhet të plotësojë kërkesat e shërbimit, forcën dhe stabilitetin gjatë gjithë jetëgjatësisë së saj projektuese, pa humbje të konsiderueshme të shërbimeve apo të mirëmbajtjes së pa parashikuar. Kërkesat e mbrojtjes së strukturës do të përcaktohen duke marrë në konsideratë përdorimin e synuar të saj, jetëgjatësinë e saj projektuese, programin dhe veprimet kryesore.

Mbrojtja ndaj gjërryerjeve të shufrave të çelikut varet nga densiteti, kualiteti dhe trashësia e shtresës mbrojtëse dhe e madhësisë së plasaritjeve në beton. Densiteti dhe kualiteti i shtresës mbrojtëse arrihet duke kontrolli i koeficientit maksimal ujë/çimento dhe përmbajtjen minimale të çimentos dhe mund të jenë të lidhura me një klasë minimale të forcës së betonit.

- Kushtet mjedisore

Kushtet mjedisore klasifikohen sipas Tabelës 4.1 të EN 1992-1-1, e cila është e bazuar në EN 206-1.

Sipas tabelës së sipërpërmendur, elementët e veprave të artit që po projektohen (në lidhje me korrozionin) i takojnë klasës:

XC1 E thate ose vazhdimisht e lagësht.

XC2 E lagësht dhe rrallë herë e thatë, Betoni shpeshherë subjekt i ujit. Themele.

Në funksion të këtyre klasave të ekspozimit do të përcaktohen klasa e betonit që duhet përdorur së bashku me madhësinë e shtresës mbrojtëse.

- Jetëgjatësia projektuese

Jetëgjatësia projektuese është përcaktuar duke u bazuar në EN 1990.

Jetëgjatësia projektuese duhet të specifikohet, siç është e nevojshme për përcaktimin e veprimeve të projektimit (p.sh reagimet sizmike), karakteristikat e materialeve (p.sh lodhja), për zhvillimin e strategjive të mirëmbajtjes, etj.

Kategoritë e jetëgjatësisë projektuese	Vlerat treguese të jetëgjatësisë (në vjet)	Shembuj
1	10	Struktura të përkohshme
2	10 to 25	Pjesë të zëvendësueshme të strukturave p.sh trarë urash,, mbështetjet e urave etj.
3	15 to 30	Struktura bujqësore dhe struktura të ngjashme
4	50	Struktura banimi dhe struktura të tjera të zakonshme
5	100	Struktura monumentale, urat dhe struktura të tjera të inxhinierisë civile

Figura 9. Përcaktimi i Jetëgjatësisë Projektuese

- Përcaktimi i klasës së betonit

Përcaktimi i duhur dhe më jetëgjatë i klasës së betonit bëhet për të mbrojtur betonin nga agjentët e ndryshëm të jashtëm dhe mbrojtjen e armaturës së çelikut nga gërryerjet, kjo kërkon marrjen në konsideratë të përbërjes së betonit.

Për klasat e ekspozimit të zgjedhura me lart, në përputhje me Tabelën E.1N në EN 1992.1.1, është përcaktuar klasa e betonit siç jepet më poshtë:

Klasat e ekspozimit në përputhje me Tabelën 4.1										
Korrozioni										
	Korrozion i shkaktuar nga karbonizimi				Korrozioni i shkaktuar nga kloruri			Korrozioni i shkaktuar nga kloruri i ujit të detit		
	XC1	XC2	XC3	XC4	XD1	XD2	XD3	XS1	XS2	XS3
Tregues i klasës së betonit	C20/25	C25/30	C30/37		C30/37		C35/45	C30/37	C35/45	
Dëmtimet në Beton										
	Nuk ka rrezik		Ngrije/shkrije			Sulmi kimik				
	X0		XF1	XF2	XF3	XA1	XA2		XA3	
Tregues i klasës së betonit	C12/15		C30/37	C25/30	C30/37	C30/37			C35/45	

Figura 10. Tabela E.1N e EN 1992-1-1, përshkrimi i klasës së betonit për kategori të ndryshme ekspozimi

- Shtresa mbrojtëse e armaturës së çelikut

Shtresa mbrojtëse minimale duhet të përmbushë dy kritere, lidhjen e çelikut me betonin dhe durueshmërinë:

$$c_{min} = \max \{c_{min,b}; c_{min,dur}; 10\text{mm}\}$$

$c_{min,b}$ (lidhja e çelikut me betonin) jepet në Tab. 4.2 të EN 1992-1-1 si:

$c_{min,b}$ = diametri i shufrës (përmasa maksimale e agregatëve ≤ 32 mm)

Në rastin tonë, vlera e $c_{min,b}$ është: 14mm

$c_{min,dur}$ jepet në Tab. 4.4N, në varësi të: klasës së ekspozimit (Tab. 4.1) / klasës strukturore (Tab. 4.3N)

Në rastin tonë, vlera e $c_{min,dur}$ është: 30mm (për Klasë Strukturore S5 dhe klasë ekspozimi XC4).

Shtresa mbrojtëse e normuar, e cila gjendet në vizatime dhe që përdoret në llogaritje, merret duke shtuar vlerës minimale një devijim të mundshëm për të garantuar se kjo vlerë minimale do respektohet gjatë zbatimit.

$$c_{nom} = c_{min} + \Delta c_{dev}$$

Përfundimisht: $c_{nom} = 30$ mm për elementët e strukturave mbajtëse.

- Vetitë fiziko – mekanike të materialeve

Materialet që do të përdoren për projektimin e strukturës (betoni dhe çeliku) duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara në Eurokodin 2 si dhe në Eurokodin 8.

EN 1998-1, 5.5.1(3) P kërkon që në elementët parësorë sizmikë të përdoret çelik armimi sipas EN 1992, Tabela C.1. EN 1998-1, 5.5.1(1) P kërkon që të mos përdoret klasë betoni më e ulët se C20/25 për klasë duktiliteti DCH.

Zgjedhja e materialeve u kushtëzua edhe nga respektimi i klasave orientuese të Tabela E.1N të EN 1992-1. Betoni dhe çeliku i armimit për strukturën janë si më poshtë (sipas EN 1992-1-1).

Betoni

Klasat e betonit C20/25 është përdorur për projektimin e mureve. Zgjedhja e klasës së betonit është bërë duke u bazuar mbi:

1. *Klasat indicative të rezistencës së betonit nga Eurocode 2 dhe Eurocode 8, minimi i kërkesave është dhënë në paragrafin e mësipërm;*
2. *Projektimi paraprakë strukturorë që çon në optimizmin e përdorimit të materialeve.*

Marrëdhëniet sforcim-deformim të betonit për projektimin e seksioneve tërthore paraqiten më poshtë:




Figura - 9 –Diagramat sforcim – deformim për betonin

- Armatura e Çelikut

Armatura e Çelikut që do të përdoret duhet të gëzojë veti të mira si në rezistencë ashtu edhe në deformueshmëri (duktilitet). Duke u bazuar në EC2, armatura e çelikut që do të përdoret është e

klasave A, B ose C, Tabela C.1. Duke u bazuar në EC8, në zonat kritike të elementëve kryesore sizmike me klasë duktiliteti të mesme DCM, duhet të përdoret armatura e çelikut e klasës B ose C sipas EN 1992-1-1:2004, Tabela C.1 (tabela e mëposhtme).

Forma e produktit		Shufrat dhe kavot			Rrjetë teli			Kërkesat ose vlera kuantile (%)
Klasa		A	B	C	A	B	C	-
Rezistenca karakteristike në rrjedhshmëri f_{yk} ose $f_{0,2k}$ (MPa)		400 deri në 600						5.0
Vlera minimale e $k=(f_t/f_y)_k$		≥ 1.05	≥ 1.08	≥ 1.05 < 1.35	≥ 1.05	≥ 1.08	≥ 1.05 < 1.35	10.0
Deformimi karakteristik për forcën maksimale, ϵ_{uk} (%)		≥ 2.5	≥ 5.0	≥ 7.5	≥ 2.5	≥ 5.0	≥ 7.5	10.0
Përkulshmëria		Testi në përkulje / ri-përkulje			-			
Rezistenca në forcë prerëse		-			0.3A F_{yk} (A është sip. e telit)			Minimum
Devijimi maksimal nga masa nominale (Shufër individuale ose telit) (%)	Madhësia nominale e shufrës (mm)							5.0
	≤ 8	± 6.0						
	> 8	± 4.5						

Figura - 10 –Tabela C.1 e EN 1998-1-1, përshkrimi i karakteristikave të armaturës së çelikut

Për të gjithë elementët strukturorë, armatura e çelikut e zgjedhur do të jetë e klasës **B** me karakteristikat e përshkruara në tabelën e mësipërme. Vlera e rezistencës në rrjedhshmëri është $f_{yk}=500\text{MPa}$.

Ngarkesat dhe Veprimet dhe kombinimet e tyre

- Pesha vetjake e elementëve

Pesha vetjake është llogaritur me ndihmën e vizatimeve, duke përdorur vlerat e normuara të përmasave të paraqitura dhe duke përdorur vlerat e peshave volumore të sugjeruara në EN 1991-1. Pesha volumore e betonit të armuar e përdorur për dimensionimin dhe llogaritjen e strukturave mbajtës b/a marrë 23.56kN/m^3 ndërsa pesha volumore e betonit C20/25 e përdorur për llogaritjen e mureve është marrë 24kN/m^3 .

- Presioni i dheut në anë të mureve b/a

Materiali mbushës pas/para mureve mbajtës/pritës do të jetë material granular me peshë volumore $\gamma=19.0\text{kN/m}^3$ dhe kënd fërkimi të brendshëm $\phi \geq 35^\circ$. Këndi fërkimit strukturë-material i përdorur në llogaritje është $\delta = \frac{2}{3}\phi = 23.3^\circ$. Ky material është konsideruar pa kohezion. Presioni aktiv i dheut është llogaritur me metodën e Coulomb-it ndërsa presioni pasiv me metodën e Caquot-Kerisel.

Në rastin e mureve mbajtës, ato janë të pajisur me tuba plastik të vendosur në formë shahu për te larguar ujin në qoftë se do të ketë prezencë ujrash nëntokësor, për këtë arsye niveli maksimal i


ujrave nëntokësore është konsideruar poshtë nivelit të murit dhe nuk është marrë në konsideratë në llogaritjen e mureve.

- Veprimet vertikale të trafikut

Madhësia e veprimeve të përkohëshme të trafikut për të cilën është llogaritur muri është $q=20.00\text{kN/m}^2$, duke mbuluar efektin e ngarkesave të përkohshme. Kjo ngarkesë është pranuar e tillë, duke marrë në konsideratë rëndësinë e rrugës, si rrugë lagjie, që nuk do të kalojnë makina të tonazhit të lartë, por vetura të vogla.

- Veprimet sizmike

Per përcaktimin e sizmicitetit të zonës ku shtrihet sheshi i këtyre strukturave, jemi mbështetur në hartën e rajonizimit sizmik sipas hartës të vitit '78, (referuar KTP-N.2-89) si dhe në "Hartën e ripunuar të nxitimeve maksimale referencë në truall të Tipit A" Tirane 2010, me autor Aliaj, Sh.; Koçiu, S.; Muço, B.; Sulstarova, E.. Sipas këtij raporti, sheshi i ndërtimit të përfshihet në zonën me Intensitet Sizmik të shkallës 8.0 ($a/g = 0.25$), i cili i përket zonës 2 sipas Eurocode 8.



- Bazamenti i mureve mbajtës

Në modelet llogaritëse bazamenti i përdorur është marrë me karakteristikat e mëposhtme:

- *pesha volumore $\gamma=19\text{kN/m}^3$*
- *këndi i fërkimit të brendshëm të materialit $\phi_{ef}=27^\circ$*
- *këndi i fërkimit material strukturë $\delta=18^\circ$*
- *materiali i bazamentit është marrë pa kohezion $c_{ef}=0\text{kPa}$*
- *pesha volumore e ngopur me ujë $\gamma_{sat}=19\text{kN/m}^3$*
- *moduli Puasonit $\nu=0.3$*

- moduli oedometrik $E_{oed}=125\text{MPa}$ cka përfaqëson tokat zhavorishte.

Bazamenti duhet të ketë aftësi mbajtëse (kapacitet bearing R) siç shpjegohet në paragrafët e mëposhtëm dhe në shënimet në fletët e vizatimeve.

Përpara fillimit të punimeve të çdo strukture të kryhen provat laboratorike nga një laborator i çertifikuar dhe të verifikohen parametrat e bazamentit, në rastet kur bazamenti nuk i plotëson këto parametra duhet të merren masat e nevojshme me miratimin e inxhinierit. Provat janë të detyrueshme të kryhen në çdo rast kur kemi ndryshim të përbërjes gjeologjike të bazamentit, me kërkesë të inxhinierit.

- Kombinimi i veprimeve

Kombinimet e ngarkesave janë bërë duke u bazuar dhe referuar paragrafit 6.4.3.2 tek EN1990.

Kombinimi i veprimeve për situata projektimi të vazhdueshme dhe kalimtare

Referuar paragrafit 6.4.3.2 të EN 1990, kombinimi themelor mund të shkruhet:

$$\sum_{j \geq 1} \gamma_{Gj} \cdot G_{k,j} + \gamma_{Q,1} \cdot Q_{k,1} + \sum_{i > 1} \gamma_{Q,i} \cdot \psi_{0,i} \cdot Q_{k,i}$$

Kombinimet e veprimeve për situata sizmike projektuese

Referuar paragrafit 6.4.3.3 të EN 1990, kombinimi sizmik mund të shkruhet:

$$\sum_{j \geq 1} G_{k,j} + \gamma_I \cdot A_{Ed} + \psi_{2,1} \cdot Q_{1,k} + Q_2$$
$$(G_S + G_P + G_F + G_{PS}) + \gamma_I \cdot A_{Ed} + \psi_{2,1} \cdot Q_{1,k} + Q_2$$

Kombinimet e veprimeve për Gjendjet Kufitare të Shërbyeshmërisë (SLS)

Kombinimi karakteristik:

$$\sum_{j \geq 1} G_{k,j} + P + Q_{k,1} + \sum_{i > 1} \psi_{0,i} \cdot Q_{k,i}$$

Kombinimi karakteristik përdoret normalisht për gjendjet kufitare të pakthyeshme.

Kombinimi i shpeshtë:

$$\sum_{j \geq 1} G_{k,j} + P + \psi_{1,1} Q_{k,1} + \sum_{i > 1} \psi_{2,i} \cdot Q_{k,i}$$

Kombinimi i shpeshtë përdoret normalisht për gjendjet kufitare të pakthyeshme.

Kombinimi thuajse i përhershëm:

$$\sum_{j \geq 1} G_{k,j} + P + \sum_{i > 1} \psi_{2,i} \cdot Q_{k,i}$$

Kombinimi thuajse i përhershëm përdoret për efektet afatgjatë dhe për pamjen e strukturës.

Për vlerën përfaqësuese të veprimit të parasforcimit, duhet bërë referenca e duhur në Eurokodin përkatës në funksion të parasforcimit të konsideruar.

8. Shtresat rrugore

Dimensionimi i shtresave rrugore parashikohet te behet mbi bazën e teorisë se elasticitetit me metodën AASHTO bazuar ne “Guide for Design of Pavement Structures”-1993, si dhe me metodën e Deformacioneve, metode qe kontrollojnë me mire nderjet ne tërheqje ne fibrat e poshtme te shtresave te sipërme te mbulesave rrugore dhe nderjet ne prerje ne tabanin e dheut dhe ne shtresat e poshtme te rrugës. Metodatat procedojnë me modulet e elasticitetit te tabanëve dhe te shtresave dhe me ekuivalentet e tyre CBR, duke patur parasysh se kemi te bëjmë me mbulesa rrugore elastike. Duke patur parasysh se këto rajonet ku kalon rruga kane kushte gjeologjike te njëjta te dhëna ne raportin gjeologjik eshte llogaritur vetëm një profil tërthor tip.

Siç u tha dhe me lart dimensionimi i shtresave dhe verifikimi i tyre bazohet ne:

- Metodën AASHTO “Guide for Design of Pavement Structures”-1993
- Metodën gjysme empirike te Deformacioneve

Karakteristikat paraprake baze janë:

- Trafiku komulativ i konvertuar AADT ne jetëgjatësinë 15-20 vjeçare te rrugës;
- Ulja elastike e lejuar;
- Moduli i kërkuar elastik minimal,

Mjeti njësi eshte mjeti me ngarkese ne aksin e mbrapem 10 ton ngarkese boshtore (për njëren metode dhe 8.16 ton për metodën tjetër) si dhe ngarkese $P=5$ ton ne çiftin e rrotave dhe presion specifik $p=0.6$ Mpa dhe sipërfaqe kontakti te përafërt rrethorë me diametër $D=32.6$ cm. Shtresat e reja me asfalt dimensionohen ne baze te teorisë se elasticitetit me deformim elastik te lejuar nen rrotën e automobilin qe dimensionohet.

Deformimi elastik i lejuar nen rrote me peshe $P=5$ ton përcaktohet me formulën empirike:

$$S_{5lej} = \frac{0.285}{lg R_{15} + 1} \text{ cm}$$

ku R_{15} eshte intensiteti dimensionues i trafikut për periudhën 15 deri 20 vjeçare.

Kompozimi i mëtejshëm i shtresave rrugore mendohet te jete:


- Nënshtrës (subgrade)

Kjo parashikohet te përbehet si me poshtë :

- Ne rastin e mbushjeve

Kur këto janë ndërtuar me zhavorre lumore, mund te konsiderohet vete traseja si nënshtrës me kushtin qe te plotësoje kondicionet teknike te ngjeshjes te shtresës se sipërme (95%).

2/2



Si përfundim zona e parkimit, do realizohet me mbistrukturë fleksibile, me shtresa asfaltike e përberë nga:

1. Asfaltobeton - 3cm
2. Binder - 5cm
3. Stabilizant - 10cm
4. Shtrese çakëll - 15cm
5. Mbushje me materiale te nxjerra nga gërmimet

PROJEKT TOPOGRAFIK



SUBEKTI

RILEVIM I BOGA QENDER

Festim
Bregasi

Digitally signed
by Festim
Bregasi
Date:
2020.10.05
11:32:15
+02'00'




Permbledhja

1. OBJEKTIVI I MATJEVE TOPOGRAFIKE	3
2. MATJET TOPOGRAFIKE	3
2.1 Metodologjia e matjeve	4
2.2 Instrumentet dixhitale të përdorura gjatë matjeve topografike për të përmbushur standardet.....	7
3. ANEKSET QE I ATASHOHEN KETIJ RAPORTI	8



1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Boga është një fshat turistik në Veri të Shqipërisë i cili i përket Bashkisë Malisë së Madhe .
Lugina e Boges ka një lartësi mesatare rreth 1000 metra mbi nivelin e detit. Kjo Lugina që përshkohet nga Perroni i Thate fillon në Grykë të Lugjeve dhe perfundon në Qafë Tethores me rreth 1700 m mbi nivelin e detit. Gjersia gjeografike është rreth 42 gradë e 29 minuta. Boga si fshat “rrethohet” nga tre Male mjaft të larta ,si : Mali i Livadhit me 2494 m lartësi , Mali i Rrabes me 2222 m lartësi ,dhe Mali i Bridashit me 2128 m lartësi (mbi nivelin e detit). Lartësitë e këtyre maleve përherë janë të mbuluara me bore ,gje që influencën në freskin e mrekullueshme të Boges gjatë muajve të Verës



2. OBJEKTIVI I MATJEVE TOPOGRAFIKE

Objekti i matjeve Topografike është të sigurojmë një hartë të detajuar të rrugëzimit në zonën e projektit si një bazë për përgatitjen e një projekti të hollësishëm të sistemit të kanalizimit të mbledhjes, për të vendosur shënjestret e tokës (standardet) në zonën e studimit në intervale të përshtatshme për kontrollin e tokës gjatë studimit dhe për përcaktimin gjatë fazës së ndërtimit.

Objekti i matjeve topografike është që të sigurojmë plane të detajuar mbi zonën specifike në qendër Boge si bazë për përgatitjen e një projekti të hollësishëm urbanistik.

3. MATJET TOPOGRAFIKE

Duke pasur parasysh mungesën e udhëzimeve fikse për ushtrimin e matjeve dhe nga angazhimi për të mbajtur një nivel të lavdërueshëm të praktikës, matjet topografike janë kryer në përputhje me kërkesat e nevojshme të bazuar në praktikë të mira profesionale, njohurive dhe teknologjive.

Në këtë kuader ne jemi në gjendje të përcaktojmë me saktësi absolute zonën e kërkuar nga klienti.

Në këtë proces ne sigurojmë përcaktimin e vendndodhjes horizontale dhe vertikale nga karakteristikat fizike mbi sipërfaqen e tokës, duke siguruar informacion të hollësishëm mbi bazën e të cilave do hartohet projekti i të ardhmes.

3.1 Metodologjia e matjeve

Matjet topografike ndahen ne fazat e meposhtme:

- a) Ndertimi I bazes Gjeodezike ne sistemin koordinativ UTM-WGS84;
- b) Zhvillimi I Matjeve Topografike per pozicion dhe naltimetri;
- c) Piketimi I parcelave ndertimore, vendosja e piketave per sinjalizimin e kufirit te prones;
- d) Peprumime grafike dhe pune zyre (Hartat dhe raportet topografike);

Këto faza kryesore janë ndjekur me një proces rigoro të monitorimit dhe të kontrollit çdo fazë, siç kërkohet nga standardet teknike dhe kërkesat e tjera të ngjashme të zbatuara në Shqipëri.

Me marrjen e urdhrat te fillimit (udhëzimet), ekipi ka kryer kontrollin rutin te instrumenteve të përdorura për kryerjen e punimeve ne terren.

Para punimet u zhvillua një mbledhje të detajuar të informacionit ne terren, që shërbenin për të përcaktuar me saktësi metodologjinë e matjeve topografike, metodat e ndërtimit të rrjetit gjeodezik, nivelim teknike si dhe përcaktimin e organizimit të punes.



A-Pergatitja Gjeodezike


Baza mbështetese e brendeshme është vendosur duke përdorur GPS pasuar nga kontrolli me Total Station (Top Con 7501-1"). Përgatitja gjeodezike përfshirë hapat e mëposhtëm:

Nën-fazat e mëposhtme u aplikuan:

a) **Baza referuese.**

Si baza referuese u përdor sistemi koordinativ UTM dhe Project Datum WGS84 WGS84

Pikat e forta	BM nr.1	BM nr.2
X	4695185.75	4695186.105
Y	389215.2127	389218.6084
Z	1010.062	1009.859



b) **Perzgjedhja e instrumentave:** Instrumentet e përdorura për këtë studim topografik përmbushin plotësisht standardet shqiptare dhe evropiane duke përdorur mjetet më të specializuara dhe të lartë saktësi si GPS Leica 1200 & CON TOP 7501 - 1 "(Total Station).

B- Matjet Topografike

Duke u bazuar në bazën mbështetese të brendeshme u relizuan matjet në terren për përcaktimin me saktësi të pozicionit dhe naltimetrisë të objekteve të detajta të vecanta mbi sipërfaqen e tokës si rrugët, muret, ndërtesat etj.

C- Perpunimet dhe punimet e zyres– pergatitja e materialeve topografike dhe raporteve**Futja e te dhenave dhe procesimi i tyre**

- ✓ Procesimi i koordinatave dhe kuotave te marra ne terren duke u bazuar ne softwaret e posht permendur;
- ✓ Perpunimin e te dhenave sipas formateve te nevojshme te pershtatshem per perpunim (CAD – based software);
- ✓ Pergatitja e hartave bazuar ne matjet e realizuara ne terren;
- ✓ Percaktimi i procedures se interpolimit dhe dizenjimi i izohipseve;
- ✓ Ndertimi i profileve terthore;
- ✓ Vizatime dhe elaborime te ndershme per fazen e dorezimit;

Përpunimi i materialeve është realizuar me software't me të avancuar ne fushen e gjeodezis si:

- LGO process;
- Leica Geosystem;
- AutoCad Civil 3D;
- Global mapper;

Siç përshkruhet më sipër, i gjithë procesi eshte i mire- monitoruar, metodologjia është rreptësisht e bazuar në standardet ndërkombëtare dhe shqiptare.

Matjet bazohen ne kordinata absolute, duke perdorur sistemin koordinativ UTM dhe Project Datum WGS84.



3.2 Instrumentet dixhitale të përdorura gjatë matjeve topografike për të përmbushur standardet

Intrumentat e perdorur, GPS - **Leica 1200** me dy frekuenca dhe LGO software per procesimin e te dhenave.

Te dhenat teknike te instrumentit:

HORIZONTAL 5mm + 1ppm

VERTICAL 5 – 10 mm + 1ppm

AZIMUT 1 are second + 5 / baseline length in kilometres.



**Total Station:
TOP CON 7501 –1"**



4. ANEKSET QE I ATASHOHEN KETIJ RAPORTI

1. Perpilimi i Hartes topografike me pikat detaje te matura ne terren;
2. Plani I Izohipseve – relieve 3 dimensional;
3. Plani I kuotave;
4. Profilet gjatesore I aksit te rruges kryesore;
5. Seksionet terthore;
6. Ortofoto e vitit 2015 me rezulocion te larte.

* Per sa u permend me lart, gjitha u siguruan ne format Soft (format Autocad- DWG) dhe hard Copy (printime ne formatin e nevojshem si dhe ne shkallen e nevojshme per te patur nje dukshmeri sa me te mire





Digitally signed
by Festim
Bregasi
Date:
2020.10.05
11:31:07 +02'00'

D
architecture

PROJEKT:

RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË
KRONIT TE BOGËS



LEGJENDA:

GRUPI I PROJEKTIMIT:

ARKITEKT:

Ark. Taulant Dibra

Ark. Bledi Trashani

INXHINIER TOPOGRAF:

Ing. Festim Bregasi

PLANIFIKUES URBAN:

Imeld Sokoli

Rovena Plaku

INXHINIER KONSTRUKTOR

Ing. Frederik Shiroka

INXHINIER HIDROTEKNIK:

Ing. Frederik Shiroka

Ing. Blerim Kurti

INXHINIER ELEKTRIK:


Ing. Elsid Sadiku

Topografia **T-01**

Plani Topografik

Shkalla: 1:400

Data e dorëzimit: 09.09.2019




LEGJENDE:

Ndertesa	Kuneta	Izoipse
Rruge Asfalti	Aks Rruge	Pika Detaje
Rruge çakulli	Mur	

1:400

0 8 16
Meters



architecture

PROJEKT:

**RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË
KRONIT TE BOGËS**



LEGJENDA:

GRUPI I PROJEKTIMIT:

ARKITEKT:

Ark. Taulant Dibra

Ark. Bledi Trashani

INXHINIER TOPOGRAF:

Ing. Festim Bregasi

PLANIFIKUES URBAN:

Imeld Sokoli

Rovena Plaku

INXHINIER KONSTRUKTOR

Ing. Frederik Shiroka

INXHINIER HIDROTEKNIK:

Ing. Frederik Shiroka

Ing. Blerim Kurti

INXHINIER ELEKTRIK:

Ing. Elsid Sadiku

Topografia

Plani Topografik


Shkalla:

T-02

Data e dorëzimit:

1:400

09.09.2019



LEGJENDE:

- | | | |
|---|---|--|
| — Ndertesa | — Kuneta | — Izoipse |
| — Rruge Asfalti | — Aks Rruge | + Pika Detaje |
| — Rruge çakulli | — Mur | |

1:400

0 8 16
Meters

PROJEKT:

RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË
KRONIT TE BOGËS



LEGJENDA:

GRUPI I PROJEKTIMIT:

ARKITEKT:

Ark. Taulant Dibra

Ark. Bledi Trashani

INXHINIER TOPOGRAF:

Ing. Festim Bregasi

PLANIFIKUES URBAN:

Imeld Sokoli

Rovena Plaku

INXHINIER KONSTRUKTOR

Ing. Frederik Shiroka

INXHINIER HIDROTEKNIK:

Ing. Frederik Shiroka

Ing. Blerim Kurti

INXHINIER ELEKTRIK:


Ing. Elsid Sadiku



TopografiaT-03

Profili gjatesor i aksit te rruges

Shkalla:1:300

Data e dorëzimit:09.09.2019





Alkal. Ruqosa
Numeri Profil: -1-
Progresivi: 0+001.15
Shkalla: 200:200
Kuota.Referense: 997.50

Dist.Prog.Tokes		0+001.15	0+002.00	0+003.00	0+004.00	0+005.00	0+006.00	0+007.00	0+008.00	0+009.00	0+010.00	0+011.00	0+012.00	0+013.00	0+014.00	0+015.00	0+016.00	0+017.00	0+018.00	0+019.00	0+020.00
Kuota Tokes		997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50
Dist.Pjes.Tokes		0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85

Alkal. Ruqosa
Numeri Profil: -2-
Progresivi: 0+020.00
Shkalla: 200:200
Kuota.Referense: 997.50

Dist.Prog.Tokes		0+020.00	0+021.00	0+022.00	0+023.00	0+024.00	0+025.00	0+026.00	0+027.00	0+028.00	0+029.00	0+030.00	0+031.00	0+032.00	0+033.00	0+034.00	0+035.00	0+036.00	0+037.00	0+038.00	0+039.00	0+040.00
Kuota Tokes		997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50	997.50
Dist.Pjes.Tokes		0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85

Alkal. Ruqosa
Numeri Profil: -3-
Progresivi: 0+040.00
Shkalla: 200:200
Kuota.Referense: 1000.50

Dist.Prog.Tokes		0+040.00	0+041.00	0+042.00	0+043.00	0+044.00	0+045.00	0+046.00	0+047.00	0+048.00	0+049.00	0+050.00	0+051.00	0+052.00	0+053.00	0+054.00	0+055.00	0+056.00	0+057.00	0+058.00	0+059.00	0+060.00
Kuota Tokes		1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50	1000.50
Dist.Pjes.Tokes		0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85

Alkal. Ruqosa
Numeri Profil: -4-
Progresivi: 0+060.00
Shkalla: 200:200
Kuota.Referense: 1003.50

Dist.Prog.Tokes		0+060.00	0+061.00	0+062.00	0+063.00	0+064.00	0+065.00	0+066.00	0+067.00	0+068.00	0+069.00	0+070.00	0+071.00	0+072.00	0+073.00	0+074.00	0+075.00	0+076.00	0+077.00	0+078.00	0+079.00	0+080.00
Kuota Tokes		1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50
Dist.Pjes.Tokes		0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85

Alkal. Ruqosa
Numeri Profil: -5-
Progresivi: 0+080.00
Shkalla: 200:200
Kuota.Referense: 1003.50

Dist.Prog.Tokes		0+080.00	0+081.00	0+082.00	0+083.00	0+084.00	0+085.00	0+086.00	0+087.00	0+088.00	0+089.00	0+090.00	0+091.00	0+092.00	0+093.00	0+094.00	0+095.00	0+096.00	0+097.00	0+098.00	0+099.00	0+100.00
Kuota Tokes		1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50	1003.50
Dist.Pjes.Tokes		0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85

PROJEKT:

RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË
KRONIT TE BOGËS



LEGJENDA:

GRUPI I PROJEKTIMIT:

ARKITEKT:

Ark. Taulant Dibra

Ark. Bledi Trashani

INXHINIER TOPOGRAF:

Ing. Festim Bregasi

PLANIFIKUES URBAN:

Imeld Sokoli

Rovena Plaku

INXHINIER KONSTRUKTOR

Ing. Frederik Shiroka

INXHINIER HIDROTEKNIK:

Ing. Frederik Shiroka

Ing. Blerim Kurti

INXHINIER ELEKTRIK:

Ing. Elsid Sadiku

Topografia

Seksionet terthore 1-5




Shkalla:

T-04

1:200

Data e dorëzimit:

09.09.2019



PROJEKT:

RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË
KRONIT TE BOGËS



LEGJENDA:

GRUPI I PROJEKTIMIT:

ARKITEKT:
Ark. Taulant Dibra

Ark. Bledi Trashani

INXHINIER TOPOGRAF:

Ing. Festim Bregasi

PLANIFIKUES URBAN:

Imeld Sokoli

Rovena Plaku

INXHINIER KONSTRUKTOR

Ing. Frederik Shiroka






INXHINIER HIDROTEKNIK:

Ing. Frederik Shiroka

Ing. Blerim Kurti

INXHINIER ELEKTRIK:

Ing. Elsid Sadiku



PROJEKT:
**RIKUALIFIKIMI I SHESHIT TË
KRONIT TE BOGËS**



LEGJENDA:

GRUPI I PROJEKTIMIT:

ARKITEKT:
Ark. Taulant Dibra

Ark. Bledi Trashani

INXHINIER TOPOGRAF:
Ing. Festim Bregasi

PLANIFIKUES URBAN:
Imeld Sokoli
Rovena Plaku

INXHINIER KONSTRUKTOR
Ing. Frederik Shiroka

INXHINIER HIDROTEKNIK:
Ing. Frederik Shiroka
Ing. Blerim Kurti

INXHINIER ELEKTRIK:
Ing. Elsid Sadiku